

S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ILVI.AL” shpk

Date 21 / 10 / 2019

KREU I-re

Dispozita te Pergjitheshme

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **“ILVI.AL” shpk** eshte themeluar sipas aktit te themelimit dhe ketij statuti te perpluara dhe nenshkuar nga Ortaku:

Milto Hodo, i biri i Avni-ut, lindur ne Hekal, me 28.12.1962, banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftimin me numer 032768905, me date leshimi 09.04.2015, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Mbeshtetur ne Ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjin Nr.9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” dhe ne Legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, hartohet ky Statut, si me poshte:

NENI 1.

Emertimi i shoqerise eshte **“ILVI.AL” shpk** Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj.

Ajo rregullon poziten juridike te themeluesit dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria **“ILVI.AL” shpk** eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen shkruhet: shoqeria tregtare **“ILVI.AL” shpk**.

NENI 2.

Shoqeria **“ILVI.AL” shpk** zhvillon aktivitetin e saj si me poshte :

Tregtim mallra te ndryshme ndertimi dhe sherbime te tjera. Riparime te ndryshme dhe punime ne lartesi. Import eksport.

NENI 3.

Shoqeria ka Seline e saj ne: Lagja.18, Rr. A.Goga, Ndertese 2 kat, Zona kadast 8511. Nr Pas. 30/257, Durres

Ajo mund të çele filiale, dege dhe perfaqesi në qytete të tjera të Shqipërisë, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 4.

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj me fondet e veta.

KREU II-te

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut

NENI 5.

Ortakut i gezon këto të drejta kryesore:

- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në aktin themelimit dhe statutin e saj.
- Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike, etj.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet perfaqësuesve të tyre ose nga ata vetë.
- Të kërkojë t'i jepet të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike, etj.
- Të bëjë propozime dhe t'i paraqes ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
- Të emerojë dhe të shkarkojë perfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabel dhe likuidatorët.

NENI 6.

Ortakut ka këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotat suplementare në përputhje me aktin themelimit dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ai.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
- Pjesëmarrja në shoqëri nuk e pengon ortakun të ketë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie.

KREU III-te

Kushtet Ekonomike

NENI 7.

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në baze të leverdise ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

NENI 8.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet, operacionet e veprimtarisë së vitit financiar dhe

raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe Audituesi Ligjor miratohen nga Ortaku. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 9.

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

NENI 10.

Kapitali i Shoqerise eshte ne shumen 100,000 (njqind mije) Lek, i perbere nga 1 (nje) kuote, me vlere 100,000 Lek. Ortaku ka nje kuote kapitali si me poshte:

$$\text{Milto Hodo} = 1 \text{ Kuote} = 100\% = 100,000 \text{ Lek}$$

NENI 11.


Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e merr Ortaku. Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj, perfitohen prej Ortakut te kesaj shoqerie plus interesat si rezultat i investimit te tij. Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohet me akt noterial. Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasuriye te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

NENI 12.

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 13.

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithe pasurise se luajtshme e te palujtshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakut themelues te saj.



KREU IV-te

NENI 14

Ortaku i Vetem merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise

Kompetencat ekzekutive te tij jane:

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne objektin e veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
5. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
6. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese.
7. Emerimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
8. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektiveve te shoqerise.
9. Percaktimi i madhesis se kuotave per formimin e kapitalit-baze te shoqerise.
10. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
11. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
12. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
13. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
14. Zgjedhja e antareve per komisionin te likuidimit te cilet emrohen dhe revokohen prej tij.
15. Marrjen e vendimit per marje huaje, kredi, venie si garanci hipotekore.

NENI 15.

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga administratori i saj i Pergjithshem. Ne shoqerine "ILVI.AL" shpk administrator i shoqerise do te jete **Z.Rei Hodo**, i biri i Milto-s, lindur ne Fier, me 31.01.1996 , banues ne Durres, shtetas shqiptar, identifikuar me leternjoftimin me numer 034725566, me date leshimi 10.09.2019, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

Administratori **emerohet per nje kohezgjatje prej 5 vjetesh** financiare. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh.

Kompetencat e administratorit ne shoqeri jane:

1. Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme si dhe administron pasurine e shoqerise
2. Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.
3. Raporton dhe i pergjigjet Ortakut per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektiveve dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
4. Siguron drejtimin e shoqerise.
5. Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne domosdoshmerisht vendimin e Ortakut te Vetem ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Ortakut te Vetem.
6. Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Ortakut te Vetem.

NENI 16.

Marrdheniet e punes ne shoqeri.

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individule te punes. Mbi kete baze shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU V-te

Mbyllja e Shoqerise:

NENI 17.

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakut, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortakut heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet i pakufizuar.

NENI 18.

Kur shoqeria likujdohet:

Ortakut i Vetem emeron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij raporti te hartuar. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare i kalojne Ortakut, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

NENI 19.

Kjo Shoqeri mund te riorganizohet nepermjet bashkimit me nje shoqeri tjeter, nepermjet ndarjes ne dy apo ne shume shoqeri te tjera ose nepermjet shnderimit te formes Ligjore. Shoqeria mund te riorganizohet vetem pasi ka qene e regjistruar per te pakten 1 vit. Bashkimi i Shoqerive kryhet ne perputhje me dispozitat per mbrojtjen e konkurences.

NENI 20.

Ortakut i Vetem i shoqerise "ILVIAL" Shpk mund te administroje, krijojë ose te marre pjese ne shoqeri te tjera me te njejtin objekt veprimtarie.

NENI 21.

Per cdo pike qe nuk parashikohet ne kete statut do ti referohemi Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKU I VETEM

"ILVIAL" Shpk

Milto HODO

